



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

KA 625/24

Numri i lëndës: 2024:367002
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06775941

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen e konfliktit administrativ të paditësit T.L, e përfaqësuar nga Miljkovic Predrag avokat nga Mitrovica, Rr. Knjaz Milosa, nr. 17, kundër të paditurës Komuna Mitrovicës Veriore, Republika e Kosovës, me kërkesëpadi për anulim te vendimit të Komisionit të Ankesave 08-030/01-0011304/24 datë 10.10.2024, konform nenit 13 paragrafi 7 të Ligjit nr. 08/1-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK), jashtë seancës, më datë 29.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat Shkalles se Pare - Departamentit për Çështje Administrative shpallet jo kompetente për ta gjykuar këtë çështje administrative
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinës Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë kompetente për ta gjykuar këtë çështje juridike administrative.

A r s y e t i m

Me datë 24.12.2024, në Gjykatën Komerciale të Kosovës Departamentin për çështje Administrative, paditësja T.L, e përfaqësuar nga Miljkovic Predrag avokat nga Mitrovica, Rr.

Knjaz Milosa, nr. 17, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna Mitrovicës Veriore, Republika e Kosovës, me kërkesëpadi për anulim të vendimit të Komisionit të Ankesave 08-030/01-0011304/24 datë 10.10.2024.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale, gjykata vlerësoj kompetencën lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative vlerëson se nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Konflikti Administrativ është iniciuar nga personi fizik. Padia nuk është parashtruar nga ndonjë shoqëri tregtare, prandaj kjo gjykatë vlerëson se nuk ka kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale që përcaktojnë se “1. Gjkata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative” lidhur me par. 5 që përcakton se: “5. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nënparagrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative.” Gjithashtu në nenin 3 par. 1, nën par. 1.10 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar përkufizimi si në vijim: “Shoqëritë Tregtare – të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare”.

Mbështetur në dispozitat e lartcekura, Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve administrative të iniciuara vetëm nga shoqëritë tregtare, kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative.

Prandaj bazuar në nenin 17 të Ligjit për 06/L-054 për Gjykatat, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.625/24, datë 29.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.